



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2412 Prot.

Roskovec, më 02, 06 2020

VENDIM

NR 35, DATË 29.05.2020

“PËR MIRATIM DHE TRANSFERIM FONDESH NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2020”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 gërma b, neni 23 dhe neni 54 pika dh, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore” neni 45, të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”i ndryshuar neni 44, paragrafi II, gërma a, të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.116 datë 20.12.2019 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe ndërmarrjeve vartëse si dhe niveli maksimal i pagave për vitin 2020” si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria Juridike dhe Zyra e Shërbimeve të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë :

VENDOSI:

- Miratimin e fondit prej **964,192 lekë** për shpronësimin e pasurive që preken nga projekti “Përmirësim i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit”, fond i cili të përballohet :
500,000 lekë nga zëri kompesim për shpronësimet dhe **464,192** lekë nga fondi i kontigjencës + Fondi Rezervë të planifikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2020.

Shtohet :

Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.602 Kodi i institucionit 2113001 **964,192 lekë**

Pakësohet :

Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.606 Kodi I institucionit. 2113001

Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.604 Kodi I institucionit. 2113001



2. Miratimin e fondit prej **549,955** lekë për objektin “Hapjen e një Pus-Shpimi studimor,për përmirësimin e furnizimit me ujë të lagjes Agaçe,Bashkia Roskovec”,i cili të përballohet nga fondi për objektin “Rikonstruksion i rrugëve të parcelave me punëtori të bashkisë”i planifikuar për financim për vitin 2020 në buxhetin e bashkisë.

Shtohet :

Gr.00 Tit.06330 Kap.05 Art.231 Kodi i institucionit. 2113001 **549,955 lekë**

Pakësohet :

Gr.00 Tit.04520 Kap.05 Art.231 Kodi i institucionit. 2113001 **549,955 lekë**

3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

